

KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot më datën 09.11.2000 (dy mijë), në Dhomën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Myrvetë Përmeti, ndërmjet:

- a) Shoqërisë “PACORA DEVELOPMENT CO Ltd.”, shoqëri e krijuar dhe që vepron sipas ligjeve të Qipros, me seli në Nicosia (Arh. Makariou III, 71, Kato Deftera), me Kodin Fiskal Nr. 12085605K, përfaqësuar në këtë kontratë nga z. Andon Kokoli, mbajtës i pasaportës shqiptare Nr.0865688, në bazë të Prokurës Nr.725/07.09.2000 të redaktuar nga Noterja e Athinës znj. Ekaterini Peleqi - Voulgarki (në vazhdim e quajtur “Shitësi”).
- b) Shoqërisë Anonime “PIRAEUS BANK SA”, shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve greke, me seli në Athinë (20 Amalias Avenue & 5, Souri Str.), rregjistruar rregullisht në Rregjistrin e Shoqërive Aksionere mbajtur nga Ministria e Tregtisë me Nr.6065/06/B/86/04 përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. Dimitrios Karavias, shtetas grek, mbajtës i pasaportës greke Nr. M 145813/04.04.1996, në bazë të Prokurës Nr.2.740/12.09.2000 redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis (në vazhdim i quajtur “Blerësi”).

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. Shitësi ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër (1.474) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili. Këto aksione përfaqësojnë 1,934% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime BANKA e TIRANËS, shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të Liçensës së Veprimit Nr. 07/12.09.1996 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Për këto aksione është lëshuar një certifikatë aksioni provizore (Nr.4 datë 27.04.2000).
2. Shitësi i shtet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të të gjitha aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër (1.474) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili, që përfaqësojnë 1,934% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime BANKA e TIRANËS, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre, Blerësit i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej njëqind e dyzet mijë (140.000) GRD për aksion. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në rregjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të BANKËS së TIRANËS.

3. Blerësi ia ka paguar plotësisht Shitësit çmimin prej dyqind e gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë (206,360,000) GRD.

4. Shitësi deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.

5. Palët bien dakort që Shitësi nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj Blerësit në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.

6. Pas transferimit të aksioneve, Shitësi nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe Blerësi të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë ti zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. Blerësi ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë dhe ai do të marrë nga BANKA e TIRANËS çertifikatat përfundimtare të aksioneve kur ato të lëshohen.

7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.

8. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.


Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë ekzekutohet në katër origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, kopja e tretë mbahet nga Noteri Publik e kaopja e katërt depozitohet në Rregjistrin Tregtar, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë në prezencë të përkthyeses Violeta XHAMO lindur më 01.10.1969, lindur e banuese në Tiranë me pasaportë Nr.0063577 dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

“Pacora Development Co Ltd”

Përfaqësuar me Prokurë nga


Ardon Lovaj

BLERËSI


“PIRAEUS BANK SA”

Përfaqësuar me Prokurë nga




Përkthyesë:

Violeta Xhamo



NOTERI


NOTERE
MYRVEËS PËRMETI